



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2019:089876

Datë: 02.11.2020

Numri i dokumentit: 01234673

C.nr. 104/19

GJYKATA THEMELORE NË PEJË, Gjyqtari Fatmir Baloku në çështjen kontestimore të paditësve H. (B.) V. nga fshatiK..... dhe M. (B.) V. nga fshatiK. të cilët i përfaqëson avokati Binak Cena nga, kundër të paditurve A. (A.) E. ish nga fshatiK. tani me vendbanim të panjohur të cilin e përfaqëson përfaqësuesi i përkohshëm avokati Idriz Ibraj nga ,H. (Gj.) M.nga fshati K. të cilin e përfaqëson M. M. nga K..... dhe të paditurit E. A.të cilën e përfaqëson përfaqësuesi i përkohshëm av.Idriz Ibraj nga, me bazë juridike vërtetim i pronësisë, vlera e kontestit 1.000 euro, pas përfundimit të seancës së shqyrtimit kryesor me datë 02.10.2020, jashtë seancës me datë 02.11.2020, bie këtë:

A K T G J Y K I M

I. VËRTETOHET se paditësi H. (B.) V. nga fshatiK....., është pronar i ngastrës kadastrale me numër 555/3 me sipërfaqe prej 5465 m² Zona Kadastrale K. në bazë të mbajtjes me mirëbesim dhe paditësi M. (B.)V. nga fshatiK. është pronar i ngastrave kadastrale me numër 555/19 me sipërfaqe prej 3461 m² Zona Kadastrale K..... dhe ngastrës kadastrale me numër 555/15 me sipërfaqe prej 851 m² Zona Kadastrale Vitomiricë K.Pejë në bazë të mbajtjes me mirëbesim.

II.DETYROHEN të paditurit A. (A.) E. nga fshatiK.....,H. (Gj.) M.nga fshati K., dhe A. E. nga fshatiK., që paditësve të i' a njohin të drejtën e pronësisë së paluajtshmërisë së përkohshme si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi dhe të lejojë që paditësit si pronar, në bazë të këtij aktgjykimi, të regjistrohen në libra përkatës pronësore, pranë Drejtorisë për Gjeodezi, Pronësi dhe Kadastër në Pejë, në afatin prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, prej ditës së pranimit të këtij aktgjykimi.

Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësit nëpërmjet të autorizuarit të tyre avokatit Binak Cena nga, me datën 15.05.2012 në këtë gjykatë kanë parashtruar padi me bazë juridike vërtetim i pronësisë vlere e kontestit 1000 euro, me datën 22.05.2019 kanë parashtruar parashtrësë për precizim të padisë duke kërkuar që të vërtetohet se paditësit janë pronarë të ngastrave kadastrale me numër 555/3, 555/19 dhe 555/15 dhe të obligohen të paditurit që të e pranojnë këtë të drejtë duke u lejuar që të e regjistrojnë në regjistrin e të Drejtave Pronësore pranë drejtorisë për gjeodezi dhe Kadastër në Pejë, me datën 19.06.2019 i autorizuari i palëve paditësve ka parashtruar parashtrësë duke kërkuar që për ngastrën kadastrale nr.555/19 të përfshihet si bashkëpronarë edhe E. A.me ½ e pjesës ideale.

Në pamundësi që gjykata të ftojë të paditurit E. A. dhe E. A. dhe me qëllim të krijimit të kushteve procedurale e në propozim të palës paditëse ka caktuar me aktvendimin e datës 05.02.2014 dhe aktvendimin e datës 03.07.2019, përfaqësuesin e përkohshëm av.Idriz Ibraj nga në harmoni me dispozitat ligjore të LPK (neni 79 par.3 pika a) dhe b) të LPK-së),me vendimin e publikuar në tabelën e shpalljeve të kësaj gjykate, në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në gazetën e përditshme ditore të Kosovës „.....”.

Me datën 10.10.2019 A. V.ka parashtruar padi si ndërhyrës kryesorë kundër të paditurve , duke kërkuar që si ndërhyrës të paraqitet në këtë çështje pasi që ka interes juridik në lidhje me të, mirëpo me parashtrësën e datës 11.09.2020, A. V.nëpërmes të autorizuarit të tij av.Lulzim Balaj ka bërë tërheqjen e tij nga padia e evidentuar nën numrin C.nr.104/19, në të cilësinë e ndërhyrësit kryesor.

I autorizuari i palës paditëse në seancën e shqyrtimit kryesorë dhe në fjalën përfundimtare deklarojë se nga provat e administruara në seancat e mëparshme edhe të radhës si dhe me daljen e gjykatës në vend shikim me ekspert gjeodet është vërtetuar fakti se paditësit kanë hyrë në marrëdhënie kontraktueses dhe kanë përpiluar kontrata interne me të paditurit, këtë fakt e ka vërtetuar edhe i padituri H. M. me deklarimin e tij kur është dëgjuar në këtë gjykatë , gjithashtu edhe dëshmia e dëshmitarëve ka vërtetuar faktin relevant se paditësit janë blerës dhe posedues të ngastrave kadastrale për të cilat po zhvillohet ky kontest civil ku në njërin ngastër është ndërtuar edhe shtëpia e banimit. Paditësit janë në posedim të lirë dhe të papenguar nga askush deri më tani, për këtë arsye i propozojë gjykatës që ta aprovojë padinë dhe kërkesën e saj në tërësi si të bazuar sepse kjo padi ka edhe mbështetje në prova të administruara.

Përfaqësuesi i përkohshëm i të paditurit të parë dhe të dytë në fjalën e tij përfundimtare deklaron se : edhe pse gjatë tërë kohës të përfaqësimit si përfaqësues i përkohshëm i të paditurve kam tentuar të kontaktojë me të paditurit në mënyrë që të sqarojmë çështjet rreth kësaj shitblerjeje, nuk ka arritur dhe përpjekjet e mia kanë qenë të pasuksesshme. Mirëpo nga deklarimet e palëve në seancat paraprake, ekspertiza e ekspertit Faruk Hysenaj dhe dalja në vend është vërtetuar fakti se në këto ngastra jetojnë dhe i shfrytëzojnë paditësit. Po ashtu gjatë procedimi i dëshmitarëve u vërtetua se akti i shitblerjes së këtyre paluajtshmërive ka ndodhur. Këtë fakt në detaje e shpjegon edhe i padituri i dytë i cili ishte prezent në seancë dhe

e vërteton faktin se shitblerja ka ndodhë dhe se të gjitha prestimet nga kontrata e shitblerjes janë përmbushur nga palët dhe objekti gjegjësisht paluajtshmëria në fjalë i është dorëzuar blerësve në shfrytëzim të lirë dhe të papenguar. Nga kjo pas vërtetimit të këtyre fakteve unë si përfaqësues i përkohshëm i palës në vlerësim gjykatës që të vendosë në bazë të provave të argumentuara edhe nëse në tërësi aprovohet padia dhe kërkesa e saj, ne nuk do të kundërshtojmë.

Për të vërtetuar gjendjen faktike gjykata ka zhvilluar procedurën kontestimore dhe sipas propozimit të palëve ka administruar këto prova: Ekspertizën e ekspertit Faruk Hysenaj, dëgjimi i dëshmitarëve M. H. dhe E. G.

Pas vlerësimit të provave dhe vlerësimit të tyre së bashku gjykata, e duke u mbështetur në dispozitat e nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, arriti në përfundim se për këtë çështje kontestimore duhet të vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke e konstatuar këtë gjendje faktike:

Se paditësi H. (B.) V. nga fshatiK., është pronarë i ngastrës kadastrale me numër 555/3 me sipërfaqe prej 5465 m² Zona Kadastrale K..... në bazë të mbajtjes me mirëbesim dhe paditësi M. (B.) V. nga fshatiK. është pronarë i ngastrave kadastrale me numër 555/19 me sipërfaqe prej 3461 m² Zona Kadastrale K. dhe ngastrës kadastrale me numër 555/15 me sipërfaqe prej 851 m² Zona Kadastrale Vitomiricë K. Pejë në bazë të mbajtjes me mirëbesim.

Bazuar në gjendjen e vërtetuar faktike gjykata vlerëson se kërkesëpadia e paditësve është e bazuar dhe si e tillë duhet aprovuar ashtu që bindja e gjykatës për aprovim bazohet në dëshminë e dëshmitarit M. H. i cili në seancën e datës 23.05.2019 ka deklaruar se para dy ose tri viteve para luftës në Kosovë paditësit kanë blerë tokë dhe atë H. nga E. A. ndërsa M. nga H. M., njëri ka blerë 54 ari ndërsa tjetri 43 ari, nga ajo kohë paditësit kanë hyrë në posedim të këtyre ngastrave dhe kanë ndërtuar shtëpi, dhe nga dëshmitari Enver Gashi i cili deklarojë që ka qenë viti 1996 kur Halili dhe Mustafa kanë blerë tokë nga Ervin Adroviq dhe Hamo Mehoviq afërisht njëri ka blerë 50 ari ndërsa tjetri 40 ari, dhe nga ajo kohë paditësit kanë hyrë në posedim dhe nuk i ka penguar askush, dhe deklarimi i të paditurit të dytë Hamo(Gjafer)Mehoviq i cili ka pranuar se e ka bërë shitjen e ngastrës së tij Mustafës, dhe është deklaruar se nuk e ka kundërshtuar kërkesën e tillë duke sugjeruar që gjykata të e miratojë si të bazuar.

Gjykata edhe nga ekspertiza gjyqësore e punuar nga Faruk Hysenaj, ekspert gjeodet pranë DGJPK në Pejë, ka vërtetuar se ngastra numër 555/3 janë të ndërtuara dy shtëpi banimi njëra e tipit B+P në dimensione 11.30 x 10.50 e ndërtuar para luftës së fundit në Kosovë si dhe shtëpia tjetër e tipit përdhese në dimensione 9.40x6.40 pjesa tjetër është oborr dhe livadh të cilat në teren i shfrytëzon H. (B.) V., ndërsa ngastrat 555/15 dhe 555/19 në teren janë me kulturë livadh dhe disa pemë të vjetra të cilat i shfrytëzon Mustafë (Brahim)Veseli.

Nga fotografitë e vendit ku ndodhen ngastrat që janë objekt i këtij kontesti, shihen qartë shtëpitë e ndërtuara të tipit B+P ashtu siç është përshkruar dhe konstatuara në procesverbalin e përpiluar në vend dhe ekspertizën e ekspertit gjeodet, ku janë të konstatuara saktë dimensionet e objekteve, e që janë në shfrytëzim të paditurit Halil(Brahim) Veselaj dhe Mustafë (Brahim) Veseli.

Nga ekspertiza gjyqësore me shkrim e punuar nga eksperti gjeodet Faruk Hysenaj dhe nga certifikata pronësore e bashkangjitur kësaj ekspertize është konstatuar se ngastrat kadastrale me numra P-71611015-00555-3 janë të shtrira në Zonën Kadastrale në Vitomiricë e evidentuar në emër të Adroviç Ervin në sipërfaqe prej 5465 m², dhe certifikata me numra P- 71611015-00555-15 e shtrirë në Zonën Kadastrale Vitomiricë e evidentuar në emër të Adroviç Ervin në sipërfaqe prej 851 m² certifikata pronësore me numër P-71611015-00555-19 e shtrirë në Zonën Kadastrale Vitomiricë me sipërfaqe prej 3461 m² e evidentuar në emër të Adroviç Ervin dhe Adroviç Ernes, ndërsa nga kopja e planit që i është bashkangjitur ekspertizës konstatohet shtrirja gjeografike e ngastrave kadastrale të lartcekura të cilat janë hijezuar me ngjyrë të kaltër dhe të gjelbër, nga skica e matjes konstatohet gjendja kadastrale dhe gjendja faktike.

Gjykata gjatë vendosjes shqyrtojë edhe pretendimet e përfaqësuesit të përkohshëm të caktuar për të paditurin, i cili në fjalën përfundimtare deklarojë që i'a lë gjykatës që të vendosë në lidhje me këtë çështje.

Prandaj nga të lartcekurat më lartë gjykata erdhi në përfundim se paditësit sipas bazës juridike të mbajtjes me mirëbesim në kuptim të nenit 40 të Ligjit për Pronësinë dhe të drejtën sendore e kanë fituar të drejtën e pronësisë në ngastrat kadastrale me numër P-71611015-00555-3, P- 71611015-00555-15, P-71611015-00555-19 të shtrira në Zonën Kadastrale në Vitomiricë që të gjitha me kulturë arë, paluajtshmëri të cilat i kanë në posedim të pandërprerë prej më shumë se 20 vite, ashtu që janë përmbushur tri kriteret themelore për fitimin e pronësisë në bazë të mbajtjes sipas nenit 28 par 4 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Pronësore Juridike siç janë ndërgjegjshmëria, posedimi dhe koha.

Pasi që asnjëra nga palët nuk i ka kërkuar shpenzimet e procedurës gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke u bazuar në nenin 450 të LPK-së.

Nga të lartcekurat më lartë e duke u bazuar në nenin 143 të LPK-së gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË me datë 02.11.2020

Gj y q t a r i
Fatmir Baloku

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditëve, nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykatë.